



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5700 Prot.

Roskovec, më 01, 07 2025

VENDIM

NR 29 .DATË 30.06 .2025

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MAJ 2025”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 28.05.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Maj 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1443/4 Prot.

Roskovec, më 29.05.2025

Procesverbal Nr.5

-I mbajtur sot, datë 28.05.2025, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2025.
5. Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit social "Banesë me Kosto të Ulët".
6. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2024.
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁵

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, Dh.Malka, J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: Rr.Hazizi, Zh.Metushi, E.Xhaxhaj, V.Çepele, S.Bibo Qamili, P.Toro, E.Toska.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Sp/Shërbimit Social S.Rrapushi, Dr.Ekonomik S.Çepele, Sp/Politikat e Strehimit Social Xh.Duka.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltar A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, Dh.Malka, J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo, F.Feleqi. Kryetari – faleminderit që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Roskovec e datës 28.05.2025. Për sa kohë kuorumi i nevojshëm për fillimin e kësaj mbledhje është në sallë, unë e deklaroj mbledhjen të hapur. Si pikë të parë kemi miratimin e rendit të ditës, rendi i ditës me të cilin jeni njohur që në datën 22.05.2025, është ai që ka miratuar Kryesia e Këshillit dhe është i pandryshuar. Ka dikush diskutim për sa i takon rendit të ditës ? Nuk ka diskutime. Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë rendin e ditës të shpërndarë paraprakisht tek ju.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2025.

Kryetari-gjithësej në mbledhjen e muajit Prill kanë qënë vetëm 2 vendime, lexon titujt e vendimeve sipas informacionit. Nuk kemi pasur asnjë vendim për të përcjellë në Prefekturë, pra nuk kishim asnjë vendim me karakter normativ të cilin sipas ligjit duhet ta dorëzonim në Prefekturë për konfirmim ligjor.

3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- jeni njohur të nderuar këshilltar me procesverbalin e mbajtur në mbledhjen e datës 25.04.2025. Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

4.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2025.

Kryetari- ftojë specialisten për referim dhe në varësi të nevojës së këshilltarëve për relatimin e këtij projekt-vendimi, do tja japim fjalën asaj. Leksi-materjalin përderisa e kemi këtu para e kemi parë, e kemi studiuar, ky është nga data 1-30 Prill, domethënë është ezauruar, për mua nuk është e nevojshme të diskutohet. Në këtë moment vjen këshilltarja P.Toro, prezent tani në sallë janë 15 këshilltar. Elmazi-duke parë materjalin të cilin ne kemi para, ma merr mendja se dhe kolegët të këtij mendimi do të jenë, mendoj që nuk ka asnjë lloj shtese për ta diskutuar ne si Këshill, që tja heqim njërit apo tja vëmë tjetrit prandaj jam i mendimit ta kalojmë. Fredi-në Qendrën Administrative Kurjan janë nja 4-5 familje të hequra, të skualifikuara nga ndihma ekonomike dhe këto jo për faj të vet familjarëve por për faj të inspektorese së zyrës së punës atje që është për ndihmën ekonomike, sepse ata duhet të aplikonin dy muaj me vonesë, ishin penalizuar dhe kur vajtën i thotë punonjësja e keni kaluar afatin dhe aplikojnë prapë. Ata morën prapë penalizim e kupton, pa kaluar atë 6-mujorshin ishin 5, morën prapë penalizim po jo për faj të tyre se nuk e dinin rregullin si ishte dhe unë jam i mendimit të futen sepse ata i plotësojnë kushtet, ti fusim tek 6%. Kryetari-pra nuk kemi të bëjmë me 6% që ne diskutuam në këtë mbledhje, por ju propozoni që zyra përkatëse të shikojë mundësinë nëse mund të futen tek 6%. Fredi-unë e kam diskutuar edhe privatisht me atë zonjën, se dhe kushtet janë që kush nuk futet tek ndihma ekonomike të futen tek mundësitë e tjera, dhe unë them meqë ato e plotësojnë por dhe që janë penalizuar jo për fajin e tyre, të shikohet sepse është një gjë që në fund të fundit për atë jemi këtu edhe neve edhe ata të zyrës së ndihmës ekonomike. Kryetari-do ti përcillet zyrës përkatëse shqetësimi juaj. Për sa i takon projekt-vendimit që jemi në diskutim, ka dikush nevojë për relacionin e specialistes? Dhurata-jo ska nevojë. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro. Kryetari-me 15 vota pro miratohet ky projekt-vendim sepse na u shtua edhe një kolege gjatë mbledhjes.

5.Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit social “Banesë me Kosto të Ulët”.

Specialistja Xhuljana Duka sqaron projekt-vendimin. Në mbështetje të ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, programet sociale të strehimit kanë si objektiv garantimin e aksesit në strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet dhe individët në nevojë. Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Entit të Banesave dhe Bashkisë Roskovec, ne si bashki duhet të vijojmë me përzgjedhjen e aplikimeve dhe vlerësimin e tyre për të gjitha aplikimet e ardhura si kërkesë për përfitimin nga programi “Banesë me Kosto të Ulët”. Në nenin 15 të ligjit Nr.22/2018 të ndryshuar, parashikohet se përzgjedhja e individëve apo familjeve përfituese realizohet përmes një sistemi pikëzimi, i cili miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak. Miratimi i një sistemi pikëzimi për përzgjedhjen e përfituesve nga programi i strehimit përbën një detyrim ligjor për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Në funksion të zbatimit të programit të strehimit për Banesë me Kosto të Ulët, ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin Banesë me Kosto të Ulët, në përputhje me tabelën bashkëlidhur. Hartimi dhe miratimi i sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e përcaktuara si më poshtë : kemi kushtet e strehimit në bazë të të cilave përcaktohet me përparësi si familjet që..Këshilltarët shprehen se e kanë materjalin. Kryetari-këshilltarët kanë pasur kohë të njihen me materjalin, atëherë kërkon dikush fjalën për diskutim? Elmazi- duke diskutuar kriteret të cilat janë paraqitur nga grupi i punës i ngritur pranë bashkisë, ne e diskutuam edhe në mbledhjen e Kryetarëve dhe në përgjithësi marrja e 25 pikë për çdo grup, ne ramë dakort që ajo të dali këtu në Këshill dhe të miratohet. Nuk jemi ne që do të vendosim këtu në Këshill se kush do marr dhe se kush nuk do marr shtëpi, këtu janë vetëm pikët prandaj unë mendoj që ta kalojmë kështu siç është materjali, kriteret i diskutojë grupi i punës. Dhurata- përpara se të kalojmë në miratimin e kësaj çështje, jam njohur, e kam parë me shumë kujdes sistemin e pikëzimit, tabelat dhe gjithçka tjetër. Unë dua të informohem se cili e bën përzgjedhjen e aplikimeve dhe vlerësimin e tyre, pasi keni thënë qartë aty që ne si bashki duhet të vijojmë me përzgjedhjen e aplikimeve dhe vlerësimin e tyre për të gjitha aplikimet e ardhura si kërkesë, ne si bashki, cilët ju si bashki? Xhuljana-është ngritur një komision, Komisioni i Strehimit. Dhurata-së dyti, sa është numri i aplikantëve për këto banesa me kosto të ulët, a keni ndonjë listë? Unë mendoj dhe sugjeroj pse të mos jemi pjesmarrës edhe ne në përzgjedhjen, të marrim edhe ne vendimin, të jemi edhe ne pjesë e përzgjedhjes së këtyre qytetarëve të cilët do banojnë në këto banesa me kosto të ulët. Kjo pikëzimi, ska nevojë për pikëzimin se tabela është e qartë dhe është e prerë, është statike por problemi qëndron tani pse të mos jemi edhe ne pjesë e përzgjedhjes së këtyre elementëve, se tabelën prandaj na e kanë sjellë neve sot që të bëjmë miratimin e kësaj table dhe unë sbesoj të jem kundra kësaj table të paktën mesa shoh, se është i qartë sistemi i pikëzimit, problemi është tani se cilët janë këta individët dhe sa i plotësojnë? Xhuljana- është ngritur një komision nga bashkia për vlerësimin e aplikimeve duke u bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit për strehimin Nr.22/2018, duke i shqyrtuar sipas kushteve dhe ka vendosur pikët. Në lidhje me aplikimet në total janë 104 aplikime.Dhurata- dhe sa do përfitojnë? Xhuljana-29, domethënë ka ardhur shkresa nga Enti i Banesave, 29 përfitues dhe 20 do jenë në listë pritje rezervë. Dhurata- e keni bërë përzgjedhjen? Xhuljana-jo pra, miratojmë sistemin e pikëzimit..Dhurata-a mund të marrim pjesë ne si këshilltar, ka një përgjigje? Kryetari-z.Maksi fjala për ju, në çfarë roli këshilltarët mund të angazhohen, si vëzhgues apo si pjesmarrës? Maksi-

Komisioni i Strehimit do të jetë i hapur dhe në pikëzim besoj se do të shpallet orari dhe data për të marr pjesë jo vetëm ju si këshilltar por çdo qytetar që është i interesuar në këtë mes, pa të drejtën e votës. Jorgo-duke lexuar këtë pikëzimin që juve na keni dhënë, duke parë dhe nja dy pika, unë sikur nuk jam dakort se keni përzgjedhur familje me prindër që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihet edhe vajzat nënë me 6 pikë, kur vajzat nënë i jepet 1 pikë, pse bëhet kjo? Xhuljana-kemi kushtet familjare, familje me ngarkim fëmijë i kemi dhënë 6 pikë, ndërsa në kushte sociale 1 pikë, merr pikë edhe 6 tek kushtet familjare dhe 1 pikë tek kushtet sociale. Kjo është e bazuar në ligj. Maksi-një familje që ka një vajzë në ngarkim merr 7 pikë në të dyja, se i merr në kategori të ndryshme pikësh, ndërsa atje merr dhe 1 pikë shtesë, kjo është e favorizuar merr dhe 1 pikë më tepër shtesë, se merr 6 pikë tek kategoria e parë. Pra janë 4 kategori dhe disa nënkategori, në çdo kategori vlerësohet vetëm në një nga nënkategoritë. Amarildo-në lidhje me kriteret që janë këtu do kisha vetëm një pyetje : këtu përfshihen edhe të rinjtë, mirë është të përfshihen edhe të rinjtë por idea është që prioritet duhet tu jepet familjeve që realisht janë në kushte të vështira sociale, sepse ka të rinj që mund të kenë edhe paga të mira dhe mund të paraqiten në bankë për të marr një kredi dhe jo të përfitojnë nga kjo banesë sociale, sepse besoj se do ketë raste. Koha do e vërtetojë që aty do hyjnë edhe punonjës bashkie që do përfitojnë këto banesa. Me këto kriterë ata mund ta përfitojnë por llogjikisht në kushtet ku jemi mendoj që duhet ti jepet prioritet familjeve që realisht janë në nevojë siç janë nënat, jetimët, punonjësit e FNSH-së që janë në krye të rrezikut, punonjësit e zjarrfikëses por të përjashtohen punonjësit e administratës, këtë kisha une. Maksi-sa i përketë kategorisë së punonjësve të zjarrfikëses, punonjës të Policisë së Shtetit janë kategori të favorizuara me një listë të veçantë të Këshillit të Ministrave dhe nuk kemi patur kërkesa për këtë kategori që po flasim bashkë, punonjës zjarrfikës, punonjës të Policisë së Shtetit apo punonjës të policive të tjera. Amarildo-kemi ndonjë nga këta që ka bërë kërkesë? Maksi-jo. Jorgo-as të zjarrfikses? Maksi-as të zjarrfikses. Amarildo-as të FNSH-së nuk kemi? Maksi-nuk kemi se janë favorizuar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, që marrin direkt nga Vendimi i Këshillit të Ministrave. Jorgo-po pse janë shkruajtur këtu? Maksi-se e detyron ligji, Vendimi i Këshillit të Ministrave del pas ligjit, kur ishte Taulant Balla Ministër ka nxjerrë një vendim të veçantë që të gjithë punonjësit e policisë së shtetit, punonjësit e zjarrfikseve dhe punonjësit e disa policive të tjera pyjore e të tjera me radhë, favorizohen nga VKM-ja, janë me të favorizuar sesa këta të ligjit, ndërsa ligji nuk mund ta heqë Vendimin e Këshillit të Ministrave. Sa i përketë që mund të ketë dhe punonjës bashkie jam plotësisht dakort që mund të ketë dhe punonjës bashkie, nuk i përjashton ligji e para, dhe e dyra përsa i përketë familjeve në nevojë, familjet në nevojë janë të favorizuara në kategorinë e parë, të dytë dhe të tretë por familjet në nevojë në qoftë se nuk plotësojnë kriterin e katërt të kenë aftësi paguese, se kjo vërtetë është banesë me kosto të ulët por edhe me afat të gjatë shlyerje, në qoftë se nuk kanë mundësi shlyerje juridikisht, se mund të ketë punë në të zezë, familja thotë kam punë në të zezë, kam kaq të ardhura, ato nuk quhen në qoftë se nuk i kanë juridikisht të parashikuara në një nga bankat e shtetit apo private. Në qoftë se nuk je i siguruar, në qoftë se nuk ke një fakt garant Enti i Banesave i cili është garanti i lidhjes së kontratës dhe nuk të lidh kontratën në qoftë se nuk ke juridikisht një pagë për të shlyer detyrimet. Fredi-sa është numri i banesave në total, dhe çfarë modeli janë banesat 1+1 apo 2+1? Xhuljana- kemi 1+1 dhe 2+1. Fredi-me çfarë kosto janë, me çfarë çmimi do shiten këto, do shiten me certifikatë pronësie dhe pagesa apo qera dhe në pronësi të bashkisë dhe do vilet qeraja me afat të gjatë? Ça modeli është me kosto të ulët? Lista do na jepet ne prapë, do vij për miratim këtu lista apo vet miratimi i pikëzimit dhe nuk ka nevojë më për listë, sepse dhe në Këshillat Bashkiak është miratuar dhe lista. Maksi-sot kemi para kriteret, flasim për

kriteret. Fredi-por problemi është lista, do vij për të miratuar prapë apo ska nevojë, ky vendim merret.. Maksi-ja ta mbarojë, janë 104 kërkesa, janë 29 hyrje 1+1 dhe 2+1 që janë për tu ndarë nga Enti i Banesave, pronësia nuk është në mënyrë kategorike e bashkisë, është pronësi e Entit Kombëtar të Banesave i cili është autoriteti që lidh dhe kontratën, ata që janë përfitues sipas renditjes së pikëve. Ne sot kalojmë klasifikimin sipas kategorive dhe kategoria do të jetë nga 1 deri tek 49 në mos gaboj, 29 + 20 që janë në listën rezervë =49. Një nga këta personat që kanë deklaruar që kam pagesë dhe nuk plotëson dokumentacionin tek Enti i Banesave, nuk mund të lidhi dot kontratë, vazhdon lista me ata që janë në pritje. Nuk e lidhim ne si institucion bashkie, as si ekzekutiv. Amarildo- po si është bërë përzgjedhja e listës? Maksi-nuk kemi filluar listën akoma, sot po themi para jush që një familje që ka bërë kërkesë Maksim Goga përshembull ka 3 fëmijë përshembull, ka dhe bashkëshorten, e para është në listën e të pastrehëve, plotëson kriterin e 25 pikëshit të parë, mund të marri 3 pikë atje, 7 tek e dyta, 21 tek e treta dhe 44 pikë mund të futet në listë. Jorgo-u zgjodhën 29 që përfituan, tani ç'a do bëhet me këta, do u jepet pronësia? Maksi-nuk u jepet pronësia por u jepet lidhja e kontratës me Entin e Banesave për shlyerjen e kredisë sipas afateve 20 vjeçare. Dhurata-sa e kanë detyrimin mujor? Maksi-po sflas dot tani për arsye se çdo njëri nga këta që do dali nesër në listë do shkojë tek Enti i Banesave do të lidhi kontratë me Entin e Banesave, nuk është pronë e bashkisë. Do lidhi kontratë me Entin e Banesave, nëse Enti i Banesave shikon se ai mund të jetë i pari në listë dhe nuk plotëson kriteret sipas Entit të Banesave që nuk ka të ardhura, Enti i Banesave e skualifikon direkt. Dhurata-po sa ishte numri i banesave? Maksi- e thamë 29 dhe 20 në pritje. Jorgo-ju na thatë që në komision mund të marrim pjesë vetëm të dëgjojmë, vendimmarrjen do ta merrni ju si bashki për përzgjedhjen e këtyre individeve. Maksi-jo përzgjedhjen, për klasifikimin, është tjetër gjë përzgjedhja, tjetër gjë klasifikimi. Jorgo-epo përzgjedhje, klasifikim, ku do firmosni ju si bashki. Maksi-unë mbaj përgjegjësi ligjore, ti nuk mban përgjegjësi ligjore si këshilltar. Jorgo-na fut edhe ne të mbajmë. Maksi-jo nuk mund ta bëj se nuk e përmban ligji. Jorgo-ku? ma lexo ligjin. Maksi-ligji thotë komisioni ngrihet me urdhër të Kryetares së Bashkisë. Dhurata-duhet të ishim edhe ne pjesë. Jorgo-ne kërkojmë që të bëhet një shtesë, që ne të marrim pjesë. Maksi-e ktheva përgjigjen. Jorgo-e ktheve por e ktheve si doje ti. Ne kemi një kërkesë si grup këshilltarësh, që të marrim pjesë në atë komision me të drejtë vote. Maksi-të drejtën e votës nuk e jap dot unë. Jorgo-pyet lart dhe na jep shpjegim radhës tjetër. Maksi- ligji nuk lejon që të marrin pjesë..Jorgo-ma lexo ligjin që nuk bëhen pjesë këshilltarët, lexo ligjin që ne skemi të drejtë të marrim pjesë. Maksi-ka një urdhër në bazë të ligjit që ngrihet komisioni. Jorgo-urdhërin ma jep me shkrim. Kryetari-të lutem të jemi të qartë në atë ç'a themi, mos të përsërisim kot. Maksi-nënpunesi civil mban përgjegjësi ligjore, anëtar i Këshillit nuk mban përgjegjësi ligjore dhe në qoftë se është anëtar i komisionit, dhe këtu që jeni nuk mbani përgjegjësi, ndërsa unë mbaj përgjegjësi. Dhurata- më fal por pse i miratojmë ne pastaj kur spaskemi të drejta ligjore? Maksi-e ka ligji. Kryetari-atëherë të më falni, të kuptojmë procesin që mos të bëjmë tani një gjë që nuk po merret vesh. Ne e kemi për detyrë ligjore të përcaktojmë kriteret dhe komisioni do të punojë mbi këto kritere, do të marri çdo dosje ta shqyrtojë, çdo pikë të saj për çdo dokumentacion të paraqitur nga aplikanti, të vendosi pikët e caktuara dhe në fund renditja e pikëve bën renditjen e listës përfundimtare, të pakten siç e kam kuptuar unë deri tani. Ne kemi gjithë të drejtën në qoftë se mendojmë se ky proces nuk është i rregullt të kërkojmë..Maksi-jo vetëm ju por dhe çdo aplikant apo çdo qytetar ka të drejtë. Kryetari- dhe e drejta nuk mbaron këtu por mund të vazhdojë dhe në gjykatë dhe ku të doni në qoftë se komisioni shkel pikëzimin që ne i kemi përcaktuar, mbi të cilin duhet të punojë. Unë jam dakort që të ketë një mbikqyrje dhe transparencë

edhe nga ana e këshilltarëve por edhe nga ana e qytetarëve, që të jenë gjatë punës së atij komisioni por nuk e shikoj të arsyeshme që ne si këshilltar të shkojmë tani të përfshihemi sepse kjo është punë e administratës dhe ne nuk mund të kemi dot vendimmarrje të këtij tipi, ne kemi rolin e kontrolluesit patjetër sepse na e jep dhe na e detyron ligji ta bëjmë këtë detyrë. Amarildo-në lidhje me aplikimet që keni deri tani, keni një shifër sesa janë aplikant punonjësit e bashkisë dhe punonjësit në njësitet administrative? Maksim-të paktën ne nuk mund ti hyjmë kësaj llogjike që keni ju si këshilltar, nuk i jemi futur ndonjëherë absolutisht kësaj pyetje që është me tendencë. Amarildo-jo nuk është me tendencë kjo. Maksim-për mua është me tendencë, unë të gjithë qytetarët e Bashkisë Roskovec, të të katër Njësive Administrative i kam të barabartë, të gjithë qytetarët i kam të barabartë. Amarildo-këto kriteret do e penalizojnë shumicën e këtyre zotrinjve që kanë aplikuar sepse nuk i plotësojnë kriteret në pjesën dërrmuese për të shlyer, do jenë punonjësit e administratës. Dhurata-mundet Maksim të shfaqet kjo listë, emrat, lista emërore? Maksim-patjetër, do e afishojmë listën ne, kushti i parë është që duhet të ketë statusin e të pastrehëve. Kryetari-ju lutem flisni qartë, bëni kërkesa të qarta. Ju doni një listë emërore të aplikantëve, po do të merrni një listë emërore, nuk ka nevojë që katër herë të vemi me një argument. Jorgo-jo pas votimit. Maksim-para votimit, që nesër në faqen zyrtare të Këshillit të bashkisë e ke të hapur. Disa këshilltarë të opozitës po flasin njëkohësisht (Jorgo, Amarildo) se e duan listën sot dhe në sallë ka zhurmë. Kryetari-z.Jorgo ju lutem mbani pak qetësi që të dëgjoheni çfarë po kërkon. Amarildo-zonja apo zonjusha e ka gati listën. Dhurata-dhe mund ta nisi tek grupi në watsap kaq e thjeshtë është. Kryetari-z.Amarildo për ju gjërat janë gjithmonë shumë të thjeshta dhe ju keni një zgjidhje që është ekstra çdo lloj procedure. Amarildo-varet si e mendon ti, po kërkoj një listë që ata e kanë apo jo? Kryetari-ju doni të përjashtoni disa qytetar, nuk mund të jemi ne persekutor, nuk mundet tani meqënëse ju mendoni se është më e mira, të jemi ne persekutor të dikujt i cili ka zgjedhur të punojë në bashki, nuk mund të jemi persekutor. Amarildo-kjo është e drejta, ne nuk është se mendojmë diçka që është e gabuar. Në sallë ka zhurmë. Fredi-unë kam një propozim, pavarësisht justifikimit që thotë zoti Nënkryetar i bashkisë që nuk na lejohet me ligj, kush është arsyeja që me kaq ngut, që nuk lejohet antarët e Këshillit Bashkiak të marrin përsipër? Z.Kryetar i Këshillit më vjen zor dhe më vjen shumë keq dhe për ju që ju merreni, të dali Kryetari i Këshillit të Bashkisë dhe të thotë nuk na lejohet ne anëtarëve të Këshillit. Maksim- një ndërhyrje shumë të vogël, janë të ndara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..Fredim-ore ti ndaj siç i ke ndarë. Maksim-ekzekutivi nga legjislativi janë të ndara, bëj detyrën e legjislativit mos u fut në detyrën e ekzekutivit. Fredi-ne në qoftë se futemi në të drejtat tuaja nuk na lejon ligji, të lutem më lër të mbaroj, unë të ndërpreva ty? Maksim-më fal. Fredi-z.Kryetar i Këshillit më vjen keq që edhe ju Kryetar i Këshillit Bashkiak bëhet palë dhe thotë ne si anëtar të Këshillit Bashkiak nuk kemi të drejtë të bëhemi pjesë e komisionit, me absurditet nuk mund të ndodhë. Kam 24 vjet anëtar Këshilli, një prononcim të tillë pavarësisht se nuk ka folur të paktën, të paktën ju mos të flisni por që të deklaroni që ne nuk mund të marrim pjesë, unë nuk e di se kush është detyra juaj z.Kryetar i Këshillit? Unë propozoj ne si anëtar të Këshillit Bashkiak të djathtë të kemi një, ju të keni dy të majtë, prapë numrin e votave e keni, çfarë ju shqetëson? Aq më keq dhe këshilltarët belbëzojnë, mbrojnë, nuk ka nevojë këtu për avokat. Unë shqyrzotit i kam një palë shtëpi nuk kam nevojë por në emër të transparencës, dhe juve çka ju shqetëson që jeni më të drejtë? Ky është telefon dhe unë e çoj këtu, merre ta kontrollojë kush të dojë, çka u shqetëson ju? Në qoftë se është përgjegjësi ligjore, unë mbaj përgjegjësi ligjore në qoftë se vjen këtu. Maksim-përgjegjësinë ligjore e ka ekzekutivi, jo ti. Fredi- mua mos më fol me atë ton, unë nuk jam as punonjësi juaj, mua mos më fol me atë gjuhë. Mua mos më ndërpritë se unë stë

ndërpreva pavarisist mendimit, qëllimit. Me dëgjo një sekondë ta mbaroj, ne kemi mendimin, doni, keni frikë, keni hallin e votave ? Maksi-votat i morëm ne se po të ndërpres, skemi nevojë për vota ne. Kryetari- z.Maksi..Jorgo-ore lëre ça more. Fredi-për kë vota më tregon ti mua? Dhurata-pse e kalon në politike ti? Jorgo- ti ke ndonjë rol tjetër ti? Ka faj Kryetari i Këshillit që të mban aty. Dhurata-pse e kalon politike, për çfarë votash e ke fjalën? Amarildo-jo me atë fjalor ti. Jorgo-jo me atë fjalor ti, pse kush je ti? Kemi frikë ne nga ty? Iku koha e frikës Maksi që u bën presion ti. Në sallë ka debat dhe zhurmë midis këshilltarëve të opozitës dhe Nënkryetarit z.Maksi. Fredi-të vij zor, turp të kesh, mos më trego mua votat ti. Këshilltarët e opozitës flasin njëkohësisht pa radhë, situata është e tensionuar. Kryetari-ju lutem pak etikë. Amarildo-bëj detyrën që të takon si Kryetar, mos na bëj të dalim nga vetja, po bën provokim politik, mba qëndrim për këtë punë je aty. Kryetari-sigurisht, qetësohuni, atëherë një minutë pushim. Pas pushimit rinis mbledhja. Kryetari-nuk ka mbaruar fjalën z.Fredi, përpara sesa të filloni juve sepse radha ose diskutimi ka ngelur tek ju, do ti themi djalit që të hapi dhe të fillojmë të mbajmë protokollin nga ky moment, do ju lutem të flisni me radhë, nuk kemi për të zgjidhur asnjë gjë në qoftë se do bëni edhe njëherë një seancë si kjo që bëtë me kaq zhurëm. Dhurata-kush qe shkaktari? Kryetari-asgjëkundi nuk kemi arritur. Dhurata- shkaktari cili ishte? Kryetari-shkaktarët jemi ne të gjithë bashkë. Dhurata-jo ne jo, stop provokimet këtu, nëse doni se pastaj kundërpërgjigjemi ne. Kryetari- unë nuk e mora provokim fjalën e z.Fredi i cili duhet ta dijë që Komisioni i Strehimit është ai komision që është përgjegjës për vlerësimin e këtyre praktikave dhe është komision që është ngritur me Vendim të Këshillit që përpara vitesh dhe nuk jemi ne askushi që tani mendojmë ne se është më mirë dhe duhet ta bëjmë tani, sepse përndryshe kjo është një shkelje. Dhurata-para sa viteve është bërë kjo se ne skemi qënë prezent dhe smund të mbajmë përgjegjësi. Jorgo-çdo Këshill merr vendimet e tij. Kryetari-Komisioni i Strehimit nuk është komisioni që ne do caktojmë sot. Ju lutem kur të flisni të referoheni edhe ju diku dhe jo thjesht meqënëse ju jepet e drejta e fjalës, ta keqpërdorni dhe të thoni që Kryetari se pa, Kryetari e pa. Komisioni i Strehimit është komision i ngritur tashmë. Fredi-ne për ça jemi këtu? Kur ti bëhesh avokati i administratës, unë për ça jam këtu? Për të miratuar këtë paçavure këtu? Kryetari-jo mo jo, po të më thuash se ku mbështetesh ti në fjalën tënde, jo pse ti mendon kështu dhe është kështu. Z.Maksi po ju tërheq edhe juve vëmendjen, nuk ka nevojë për replika. Fredi-po shyqyr që e bërë. Kryetari-të lutem a mund ta vazhdojë këtë mbledhje unë, se tani i bie që të marr leje përpara se të vazhdojë. Fredi- e para e punës mua nuk duhet të më ndërhyjë njeri. Maksi-mendoj se ke mirëkuptimin kur kam ndërhyrë. Kryetari-zotërinj gjithçka që keni thënë në atë zhurëm nuk është mundur që të mbahet në protokoll. Fjalja ime pas heshtjes tuaj bashkë me tërheqjen e vëmendjes së z.Maksi po shënohet tani në protokoll. Ju lutem a ka mundësi që të flisni me radhë dhe të dëgjoni njëri-tjetrin? Të lutem Juli. Antueno-ndezur ka qënë, nuk është shkëputur live. Kryetari-ai mban përgjegjësinë e vet, nëse nuk ka zbatuar protokollin është përgjegjësi e tij, gjithsesi ne skishim ndonjë gjë për të fshehur, kjo ishte thjesht për të marr kohën e qetësimin, ju lutem vazhdojmë mbledhjen. Të nderuar këshilltar vazhdon diskutimi i z.Fredi. Fredi-unë pavarisist se jemi njerëz edhe provokimeve por pavarisist z.Maksi është e dyta ose e treta herë, të vij zor z.Maksi. Kryetari-ju lutem të vazhdoni me diskutimin tuaj ose do ua pres fjalën. Fredi-votat me Fredin i ke provuar, e dyta unë se kam ndryshuar as vendbanimin. Ju jeni i vetmi Kryetar i Partisë Socialiste që keni ndryshuar, jetoni në Fier, pashaportizimin në Patos, keni bërë pastaj në Arapaj dhe keni ardhur këtu. Kryetari-z.Fredi ju lutem. Fredi-morali ka nevojë nuk ka nevojë vota, votimet ska problem ore, ka morali. Kryetari-ju lutem z.Fredi do ju pres të drejtën e diskutimit, ju lutem të qëndrojmë tek diskutimi. Fredi-unë

kisha propozim shumë të thjeshtë, ne si grup propozojmë një anëtar në Komisionin e Strehimit të përzgjedhjes, grupi tjetër të çoni dy, mund të çoni si të doni ska asnjë gjë, në emër të transparencës. Vet nga ajo që belbëzoni, vet lë të keqkuptohet. Kryetari-unë nuk po belbëzoj por ky komision është i ngritur. Fredi-atëherë ne propozojmë në emër të transparencës që qytetarët mos të paragjykojnë, unë propozoj një gjë shumë të thjeshtë që këtu mos të ketë llafollogjira, mos të ketë paragjyime dhe nuk e di kujt i dhëmb më shumë? Një anëtar Këshilli nga ne edhe dy e kupton? por në qoftë se ju vazhdoni dhe nuk jeni dakort përtej ligjit sepse në qoftë se është e jashtëligjshme ne na e kthen Prefektura dhe nuk është nevoja që të na tregoni ju juristin këtu. Ne me qëllimin e mirë, në emër të transparencës, asnjë gjë nuk kërkojmë, shumë e thjeshtë dhe kërkoj të hidhet propozimi im për një shtesë në komision, kërkoj të hidhet në votim. Kryetari-atëherë më duhet ta konsultojë nga ana juridike nëse më lejohej, që unë të bëj një veprim për kërkesën e këshilltarit dhe do të përgjigjem për këtë pak më vonë. Elmazi-unë jam plotësisht me të tëra problemet të cilët trajtuan anëtarët e Këshillit, por çdo problem që trajtohet këtu në Këshill trajtohet me baza ligjore, nuk trajtohet me fjalë boshe. Amarildo ndërhyr. Elmazi-do të lutem, se unë nuk ndërhyra kur fole ti. Kryetari-do të jetë hera e fundit që ju ndërhyri në këtë forëm, se je dhe ironik. Elmazi-atëherë shikohet baza ligjore dhe ai grup pune i cili është ngritur pranë bashkisë, ka punuar në bazë të ligjit apo ka punuar në bazë të rregullave të tyre personale? E dyta, kërkohet nga ana e Këshillit lista këtu, lista duhet të shoqërohet me tërë kriteret që ka përcjellë çdo individ 150 sa janë apo 115 dhe nuk duhet të vij lista bosh, na urdhëroni se kam prurë një listë nga kooperativa bujqësore dhe ta shikojmë ne këtu, jo zotri, ka njerëz të ngritur që mbajnë përgjegjësi ligjore dhe thirren para ligjit. Nuk jemi ne që thirremi para ligjit, nuk kam parë ndonjë këshilltar deri sot unë në Republikën e Shqipërisë që ka shkuar në SPAK, ka shkuar Titullari, ata që mbajnë përgjegjësi mbi supe dhe ne nuk duhet të ngarkojmë atë që nuk na takon. Ne sot kishim për detyrë të kalojmë pikëzimin dhe asnjë gjë tjetër, problemet e tjera i trajtojmë kur të vijnë proceset e tjera. Sa i përket që ne të kemi nga krahu ynë apo nga krahu i tyre, ne jemi një, për mua jemi një si individ, si është Feleqi jam unë apo është tjetri, nuk kemi të ndarë por problemi qëndron a është baza ligjore që neve si anëtar Këshilli të ngrejmë komision pranë bashkisë? Dhe me ç'bazë ligjore duhet ta mbështesim ne se duhet ta mbështesim, në qoftë se nuk ka bazë ligjore nuk duhet prandaj punonjësja që është në këmbë duhet të sqarojë ligjet dhe pastaj të bindemi dhe ne. Leksi- u bë një diskutim i gjatë për miratimin e pikëzimit për programin e strehimit social. Ne këtu normalisht jemi fokusuar vetëm tek kjo pikë për të kaluar këtë projekt-vendim. Çështja që ngriti dhe Elmazi dhe të gjithë kolegët këshilltar është çështja e bazës ligjore për të cilën ne u shpjeguam nga punonjësja që nuk e ndiejmë me bazë ligjore çështjen e marrjes pjesë të anëtarëve të Këshillit. Ne këtu që po kalojmë këtë projekt-vendim nuk është se kemi një listë orientuese për të cilën dhe ne do pozicionohemi përshebull 29 që janë aty do ti përzgjedhim tani dhe do lëmë 75 apo sa mund të jenë ata, ti lëmë jashtë. Kështu që ne kemi vetëm thjesht pikën e kalimit të kriterëve dhe miratimin e sistemit të pikëzimit. Nuk kam asnjë lloj emocioni për pjesën se kush janë ata dhe kush do jenë dhe kush do vij në listë, fare sepse nuk kam bërë asnjë lloj kërkesë si unë dhe të afërmit e mi. Këtu deri sa ligji ngarkon Komisionin e Strehimit, çështja është lër të vazhdojë Komisioni i Strehimit me këto sistem pikësh që kemi. Në rast se duhet për monitorim anëtarët e Këshillit, lër të jenë anëtarët e Këshillit, jo dy po tre se nuk është problemi dhe me të drejtë vote, në rast se këtu janë 6 a 7 sa janë këtu në Komision Strehimi dhe do vemi ne 2 anëtar të komisionit ose 3, nuk imponojmë dot dhe në rast se këta kanë ndërmend ti pikëzojnë dhe tu japin shtëpi jashtë kriterëve, prandaj unë them lër të jemi në çështjen e monitorimit nuk është problem fare, jam që të jenë 2 ose 3 anëtar të Këshillit ose

dhe 4 por të jenë në mënyrë të barabartë jo të ndarë 2 këtej apo 1 këtej, të jenë nga të dyja krahët politike të monitorojnë. Kryetari-do doja që për të gjithë të jetë i qartë një fakt, që ky është Komisioni i Strehimit të bashkisë, komisioni i Ekzekutivit le të themi dhe ky është një komision që nuk është se ngrihet nga ne, ne kemi komisionet tona të cilat juve dhe pas lutjeve të herë pas herëshme që ju kemi bërë dhe bashkë me shpërndarjen e materialeve përpara 5 ditësh, unë kam shënuar komisionet përgjegjëse që duhej të mblidheshin, dhe është pikërisht Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Çështjet Sociale i cili duhej të mblidhej dhe në qoftë se kishte një propozim konkret të bazuar në ligj, për një kërkesë për shtimin me të drejtë vote të anëtarëve në komision atëherë mund ta sillte, por një kërkesë të pambështetur unë nuk po e hedh as në votim në këtë mbledhje të Këshillit. Në përfundim të diskutimeve, znj.Dhurata çfarë kishte për të shtuar? Dhurata-nuk vihet në dyshim secili këshilltar ka mendimin e vet, ne sduhet ti bëjmë presion njëri-tjetrit në një forëm a një forëm tjetër se kjo shihet qartë që është bërë pak presion psikologjik megjithatë, znj.Floriana tha që i kemi në sistem listën emërore, tani ne e kërkojmë dhe po e rikërkojmë për të disatën herë, a mundemi ne për 5 minuta ta kemi në dispozicion këtu tek grupi ynë listën emërore? Floriana-ne po diskutonim që kërkesat janë bërë në sistem. Dhurata-kjo do të thotë që është në sistem se Floriana e di shumë mirë se është punonjëse e bashkisë, deri diku ka informacion. Floriana-nuk jam pjesë e administratës, se ju jeni keqkuptuar, Z.Feleqi ja thashë në mënyrë se më tha që ti po mbron administratën, unë sjam askushi për të mbrojtur administratën, as nuk e di. Dhurata-po the janë në sistem pra. Kryetari-ju lutem mos të bëjmë replika. Floriana-gjërat i merrni si të doni ju, por thashë për kërkesat, se bëhen në sistem kërkesat. Kryetari-kam një pyetje, çfarë ndryshon në sistemin e pikëzimit pra pikërisht në faktin që ne sot miratojmë sistemin e pikëzimit, listat? Në qoftë se ju do vëreni dy emra atje jeni dakort, dhe po nuk i vëreni nuk jeni, në vlerësimin tim çështja dhe projekt-vendimi për të cilën ne po diskutojmë dhe do të miratojmë nuk ka të bëjë me listën..Dhurata-po nëse ne po e kërkojmë, ç'a të keqe ka? Kryetari-ju do të pajiseni me listën por kjo nuk ka pse të jetë pengesë, do të pajiseni me listën por kjo nuk përbën pengesë për shqyrtimin e këtij projekt-vendimi, ne nuk po diskutojmë emra sot dhe kjo nuk do të thotë që fakti nëse përfshihen apo jo emra në atë listë, nuk ndikojnë në këtë projekt-vendim. Maksi-sa i përketë debatit me Fredin, unë e kisha gjithmonë në kuadrin e mirëkuptimit me njëri-tjetrin dhe ndërhyrjes mbase dhe pa takt, por nuk është problemi për të kërkuar ndjesë se e bëri vërejtjen Kryetari i Këshillit, dua ta vazhdojmë atje ku e kemi lënë tek kërkesa e këshilltarëve të djathtë. Me vendim të qeverisë shqiptare dhe në zbatim të ligjit për strehimin, Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ngrejë Komisionin e Strehimit ashtu siç dhe Këshilli i Bashkisë ka komisionet e veta të strehimit, të ekonomisë, financës, shëndetësisë e të tjera me radhë që i ka komisionet e veta. Ky komision nuk gërshetohet,nuk përputhet, nuk bashkangjitet në mënyrë kategorike Ekzekutivi me Këshillin. Legjislativi bën punën e vet miraton pikëzimin, Ekzekutivi mban përgjegjësi ligjore për zbatimin e Vendimit të Këshillit tek pikëzimi. Komisioni të cilin të paktën me urdhër e drejtojë unë është dhe do të jetë i hapur, këtë ua deklaroj personalisht dhe në emër të komisionit. Ditën, orën që do të mblidhet komisioni për të shqyrtuar 104 kërkesat, për të bërë pikëzimin, le të jenë prezent dhe të 21 anëtarët e Këshillit, le të jenë prezent nuk ka asnjë lloj problemi, unë do të jem këtu, komisioni do të jetë këtu, do themi po Maksi Goga ka këtë, lëre ç'a thotë Fredi që e ka pashaportizimin këtu apo atje, ka këtë përbërje familjare 5 veta, e ka në gjendjen civile të Bashkisë së Roskovecit, Njësia Administrative Strum. Në qoftë se është e pastrehë po, vazhdojmë pastaj kategoria e parë te kjo pikë ka dokument për këtë? Çdo punonjës i financës apo çdo punonjës tjetër juridik hap dokumentat sipas renditjes që ka në dosje dhe për çdo dokument që ka në dosje, një nga anëtarët e

komisionit mban shënim pikët. Këtë të drejtë e ka çdo qytetar dhe çdo një nga 21 anëtarët e Këshillit të bashkisë. Jemi këtu të hapur, hajt ta bëjmë këtu transparente, më mirë se kaq nuk keni përgjigje për të marr. Je anëtar komisioni, sje anëtar komisioni nuk ke të drejtë të votosh, e shikon këtë e bardha është mbi të zezë, unë nuk votoj atë ditë që të them ky e ka atë dokument apo nuk e ka, po e pati do marri pikë, po se pati nuk merr pikë, janë mbi bazën e letrave. Dhe e dyta ua them sinjerisht këtë punë, me gjithë respektin e madh që kam për anëtarët e Këshillit të Bashkisë Roskovec e kudo që bëjnë detyrën fisnike në emër të komunitetit, ashtu siç e kam bërë edhe unë njëherë e një kohë, jam i hapur për ta bërë këtë mbi bazën e transparencës, nuk kam asnjë lloj përgjegjësie personale që të kem konflikt interesi, po këtë do e kërkoj edhe për çdo anëtar komisioni kur të jetë prezent. Pse? Se është hera e parë që në Bashkinë e Roskovecit ndahen këto shtëpi me kredi të butë dhe me afat zgjatje të shlyerjes, kështu që do të jemi transparent. Mos e vrisni mendjen për të qënë unë, të vete drejt SPAK-ut apo drejt burgut, në mënyrë kategorike nuk ka pse ti hyjmë kësaj pune, do them e ka e bardha mbi të zezë? po e ka këtë letrën, po e ka urdhëro vendose këtu këtë letrën dhe jepi 3 pikë Gogos në qoftë se e meriton, Gogo do më falësh se nuk e kam për debat. Jepi Dhuratës 3 pikë se e meriton këtu, kësaj këtu dhe çdo gjë do të bëhet transparente. Në çdo Komision Ekzekutiv punon vetëm Ekzekutivi, pse? Se mban dhe përgjegjësi ligjore. Keni të drejtën ligjore, keni të drejtën morale, keni të drejtën kulturore në gjithë bagazhin tuaj kulturor dhe ligjor, për të kërkuar pikëzimet dhe për të kërkuar zbatimin e përgjegjshëm të komisionit. Kryetari-për të mbikqyrur. Maksi-mbikqyrjen unë e thashë të 21 jo 3, jam për 21 anëtar Këshilli të vijnë këtu siç janë këshilltarët, le të rrinë aty bashkë me mua dhe komisionin për ti parë. Fredi-do kalojë propozimi që bëra unë në votim apo jo? Kryetari-ju nuk keni qënë të vëmendshëm por po e përsërisë. Komisioni i Strehimit të Ekzekutivit të bashkisë është një komision mbi të cilin ne nuk mund të marrim vendime sa herë që duam këtu, të ndërhyjmë dhe të caktojmë ne anëtar..Fredin-nga e dini ju? Kryetar ku e dini ju që neve nuk kemi të drejtë? Kryetari-ju ku e dini, ku bazoheni? Ju bazoheni vetëm në hipoteza dhe hamendje dhe nuk është hera e parë. Ju lutem kjo është përgjigja ime e cila çohet në protokoll, ju mundet që këtë përgjigje që unë po ju jap ta kundërshtoni, ta çoni për interpretim juridik ku të doni ju. Po ju them edhe njëherë Komisioni i Strehimit të bashkisë është ekskluzivitet i administratës, nuk mundem të diktojë pse ti mendon se ku e di unë, të shtojë një anëtar në atë komision. Fredi-ju thatë që nuk është, ju se dini se smund të ma referoni. Kryetari-përfundimi i përgjigjes time është, përse kohë ju nuk më referoni asnjë referencë ligjore në bazë të qartë, në bazë të të cilës unë do të shtojë një anëtar të Këshillit që të jetë pjestar i këtij komisioni, unë nuk mund ta hedh çdo lloj propozimi i cili nuk ka bazë ligjore dhe nuk vjen në rrugën e duhur, që të vinte minimalisht nga komisioni përkatës. Nuk mund ta hedh në votim në këtë mbledhje. Jo të jesh i sigurt, jo po të them edhe njëherë nga frika se ky propozim do miratohet dhe do ndryshojë gjë. Fredi-po për diskutim do ma japësh fjalën para se ta hedhësh në votim? Kryetari-keni vetëm 2 minuta kohë të diskutojmë. Fredi-shiko ne si grup propozuam dhe kërkuam në emër të transparencës edhe listën paraprake të aplikuesve dhe ju nuk e miratuat, ne bëjmë 10 minuta pushim, bëjmë 20 minuta pushim, një gjysmë ore pushim, nuk ratë dakort. Propozuam anëtarë të Këshillit në komisionin e përzgjedhjes nuk jeni dakort, në emër të transparencës, në emër të ligjit, na e tregon tjetër kush ligjin, shkeljen e ligjit, na takon apo sna takon. Ne si këshilltar propozuam dhe ju nuk e miratuat. Këtu mund të ketë këshilltar që kanë dhe afera në këtë listë dhe prandaj bëjnë avokatin këtu dhe është turp për një Këshill këtu të marri përsipër këtu të bëjë avokatin e administratës ose të bëjë juristin këtu dhe të më tregojë mua se ça kam të drejtë unë, ça kam të drejtë të llafos këtu. Unë kam të drejtë të kërkoj sepse për këtë jam

këtu. Kam 2 shtëpi të lutem, 1 këtu e 1 në Tiranë, nuk kam ardhur për shtëpi unë këtu, kam ardhur për ata që më kanë zgjedhur dhe këtu të bëhen transparente, nuk kam ardhur unë të debatoj me anëtarët e Këshillit Bashkiak. Këtu jepen ca shtëpi pa lekë sepse këtu janë bërë të gjitha listat dhe listën e kam unë dhe nga ju vet socialistët dhe nga vet administrata, edhe paragjykohe mi dhe dalkemi në këtu të keq pse kërkojmë të vihet në komision, jo more zotri jo se skemi ardhur për tu bërë palaco në këtë Këshill në këtu, të miratojmë në këtu. E kam unë listën se ma ka dhënë njëri i pakënaqur që i kishte dhënë llafin Kryetarja dhe nuk ja ka dhënë, ka dy vjet ja të them.. Maksi-ku e ke? Ku e ke, nxirre listën? Fredi-mos më bërrtit mua këtu se jam në zyrën e Këshillit Bashkiak këtu, nuk jam në zyrën e Kryetares së Bashkisë, jam në zyrën e Këshillit Bashkiak, mos mi bier mua tavolinës. Ta mbarojë unë fjalën? Kryetari-zotri të lutem ulu, mjaftoi koha për diskutim. Fredi-në qoftë se ju sjeni dakort vazhdoni ju vaftë mbarë, ne nuk bëhemi pjesë e palaçollëqeve dhe e aferave korruptive këtu. Leksi-Fredi me gjithë respektin që kam për ty..Fred-faleminderit, është reciprok..Leksi-më dëgjo ta mbarojë, tani kush është këshilltari këtu se ti po na ofendon të gjithëve ne..Fred-unë nuk ofendoj asnjë..Leksi-se the këshilltarët kanë konflikt interesi se kanë aferë këtu, më thuaj se unë prekem në këtë pjesë. Fredi-mos u prek ti, në qoftë se sje pjesë e aferës mos u prek. Leksi-atëherë nxirre emrin këtu, burrat i nxjerrin emrat këtu, mos fol në mënyrë të përgjithëshme. Në sallë ka debate dhe tone të larta. Leksi-as ti dhe asnjë tjetër smund të akuzojë këtu anëtarët e këshillit. Kryetari-Fredi nuk është hera e parë që vetëm akuzoni dhe hamendësoni, nuk është hera e parë. Këshilltarët e opozitës F.Feleqi, Dh.Malka, A.Hoxha, A.Pelo, J.Begaj largohen nga salla e mbledhjes. Kryetari-ju lutem pak qetësi, është bërë e udhës në këtë mbledhje..Leksi-akuzojnë e hedhin fjalë një më dy sikur jemi ne anëtar të korruptuar. Kryetari-është bërë e udhës në mbledhjen e Këshillit pa pasur asnjë referencë të qartë për çfarë thonë, abuzojnë me të drejtën e fjalës por nuk e di sesi mund të akuzonte dikë tjetër dikush kur vet shprehet qartazi këtu që jeton dhe në Tiranë dhe në Roskovec. Kryetari-do marrim dy minuta pushim. Grupi i këshilltarëve të majtë tërhiqet për disa minuta pushim. Pas pushimit rifillon përsëri mbledhja. Në këtë moment në sallë kemi edhe këshilltaren E.Toska, prezent janë 11 anëtar. Elmazi kërkon fjalën. Kryetari- të lutem z.Elmaz përpara sesa të bëj hapjen e seancës nuk mund të flasësh. Ju lutem vetëm 1 minutë sapo të bëj hyrjen në këtë pjesë të dytë të mbledhjes pas pushimit të kërkuar fillimisht nga mua dhe më pas nga Kryetari i këshilltarëve socialist në këtë sallë. Këshilltar të nderuar shoh që në sallë na është shtuar edhe një këshilltare që nuk ishte në pjesën e parë znj.Elisabeta, ora e mbërritjes 2 e 40. Zonja këshilltare keni ndonjë arsye të fortë për vonesën? Elisabeta-po, për arsye shëndetësore. Kryetari-do ju lutem që në respekt të etikës së pjesmarrjes, do ju lutem që të jeni më korrekte në gjithë mbledhjet e ardhëshme të këtij Këshilli. Ju lutem të përcaktojmë edhe njëherë e kemi kuorumin akoma të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes? Sekretarja-po, janë 11. Kryetari-kemi 11 anëtar, atëherë kemi kuorumin për vazhdimin e kësaj mbledhje. Unë do doja që të sekretoja në bazë të nenit 26 pikës 1 dhe 2,70 dhe 71 të rregullores, kam konstatuar se disa nga këshilltarët e pranishëm deri në pjesën e parë të mbledhjes, në këtë mbledhje kanë folur në mënyrë të përsëritur dhe jashtë radhe dhe janë larguar në mënyrë demonstrative. Ky është një akt i cili bie ndesh pikërisht me rregulloren e Këshillit Bashkiak Roskovec, po e dokumentoj si rast dhe do të shikoj se cila masë disiplinore mund të merret në këto raste. Në mënyrë të veçantë dy nga këshilltarët e pranishëm dhe që u larguan në mënyrë demonstrative duke e vënë në pamundësi dhe zhvillimin e mbledhjes, duke mos u përgjigjur le të themi besimit të qytetarëve që kanë marr për ti përfaqësuar në këtë Këshill dhe pikërisht z.Fredi Feleqi dhe Amarildo Hoxha, janë dy nga këshilltarët e konstatuar të cilët kanë folur në mënyrë të

vazhdueshme, jashtë radhe dhe pas kërkesës për ndërprerjen e fjalës. Njëkohësisht në protokoll do doja të mbahej dhe një vërejtje sa i takon gjuhës së përdorur në sallë nga Nënkryetari i bashkisë sepse në këtë Këshill ne jemi për të bërë vendimmarrje të drejta për qytetarët, të qeta, me përgjegjësi dhe çdo lloj retorike me karakter politik që nuk i shërben mbledhjeve të Këshillit, është e papranueshme për zhvillimin e mbledhjeve të këtij Këshilli. Faleminderit gjithë këshilltarëve që u treguan të duruar dhe të matur për vazhdimin e kësaj mbledhje. Fjala është kërkuar dhe është tani për Kryetarin e grupit socialist z.Elmaz Çepele. Elmazi-faleminderit Kryetar, e pashë debatin i cili u zhvillua në mbledhjen e Këshillit midis grupeve të caktuara dhe unë mendova që të tërheq grupin për të marr vendimin që për të vazhduar mbledhjen në pikën e dytë, dhe jam plotësisht dakort me të dy ata, me Feleqin dhe Amarildon, tu jepet vërejtje në emër të Këshillit sipas rregullores. E dyta kërkoj nëpërmjet jush, e kemi caktuar orarin e diskutimit 2 minuta dhe nuk ke pse i lë njerëzit të kalojnë më shumë sesa aq dhe tua japësh dy herë fjalën,se kjo është ajo që pastaj lindin dhe debatet, faleminderit. Kryetari-fjalën për diskutim për projekt-vendimin që ishim duke diskutuar e kërkon akoma dikush, apo duhet ta kalojë në votim këtë projekt-vendim? Nuk ka më diskutime.Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 10 vota pro, 1 votë abstenim P.Toro. Me 10 vota pro miratohet ky projekt-vendim.

6.Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2024.

Elmazi-ne e kemi lexuar atë materjal, e kemi parë dhe jemi dakort. Kryetari-atëherë nuk dëshironi që të dëgjoni relacionin e përgatitur nga specialisti. Për diskutim e kërkon njeri fjalën, në bazë të rregullores? Ska diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

7.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-nuk konstatojë qytetarë të pranishëm në sallë. Për të diskutuar për çështje të ndryshme dëshiron ndonjë nga këshilltarët të marri fjalën? Nuk ka diskutime nga këshilltarët. Ermira-për sistemin e pikëzimit që kaluam më para desha të di diçka, a ka një afat kohor kur do fillojë komisioni punën dhe kur do ta mbarojë atë, a keni ju afate ligjore kur duhet të përfundojë? Maksi-pas vendimit që miratuat sot, afati është një muaj. Ermira-kjo lista përfundimtare do na vij ne apo do bëhet..Maksi-sipas procedurës ligjore, mund ta sjellim edhe në Këshill në qoftë se duhet për ta miratuar Këshilli. Ermira-jo për ta miratuar po them për dijeni? Maksi-në dijeni vihet çdo qytetar i Roskovecit, lista do publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të bashkisë, lista e gjithë pretendentëve që kërkojnë për banesa me kosto të ulët. Kryetari-faleminderit z.Nënkryetar, faleminderit të gjithë ju këshilltar që u treguat të matur dhe të duruar dhe përballë këtij presioni të panevojshëm gjykoj unë, të këshilltarëve të cilët në mënyrë demonstrative u larguan nga Këshilli. Në përmbushje të besimit qytetar ju falenderoj edhe unë nga zemra, për qetësinë e treguar në këtë sallë sot. Mbledhjen e deklarojë të mbyllur, faleminderit.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

